VENDIM
Nr. 141, datë 27.11.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 41, DATË 1.6.2018, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME FINIQ"

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 27.11.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 41, datë 1.6.2018, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Finiq'"

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Finiq (UK Finiq), me shkresën nr. 105 prot., datë 10.11.2020, me lëndë "Dërgim dokumentacioni", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Finiq, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e licencimit.
3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Finiq me vendimin nr. 41, datë 1.6.2018, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Finiq, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Finiq sh.a., z. Mihal Çavo, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Inxhinierisë, në degën Hidroteknikë.
5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Finiq sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Finiq është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 41, datë 1.6.2018, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Finiq" bëhen këto ndryshime:

"Drejtues Ligjor: z. Mihal Çavo"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani